

KONTRATË SHITBLERJE KUOTA KAPITALI

Kjo Kontratë Shitblerje Kuota Kapitali "referuar në vijim si Kontrata" është lidhur sot më 04.01.2022 ndërmjet:

Z. Isuf Kore shtetas shqiptar, lindur ne Gjirokaster më 04.08.1957, identifikuar me numër personal F70804069J, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar (referuar më poshtë si "**Shitësi**").

Dhe

Shoqëria "ITE. GRUP"shpk me NUIS K11323001H dhe adresë në Rrugën Dytësore Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, përfaqësuar nga **Z. Sokol Zotkaj** shtetas shqiptar, lindur ne Tirane më 07.05.1956, identifikuar me numër personal F60507103W, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar (referuar më poshtë si "**Blerësi**").

Shitësi dhe Blerësi do të referohen më poshtë vecmas si "**Pala**" dhe bashkarisht si "**Palët**".

MEQËNËSE

Shitësi është titullar i një kuote në masën 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë "EUROTEST"shpk me NUIS L11823002I me kapital prej 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe adresë në Kashar Mëzez, objekti me nr.pasurie 7/43, zona kadastrale 2679, Tiranë.

Shitësi synon t'i shesë Blerësit, i cili synon të blejë, një kuotë në masën 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë "EUROTEST"shpk.

Në vendimin e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "EUROTEST"shpk të datës 03.01.2022 është vendosur për transferimin nëpërmjet shitblerjes së kuotave të kapitalit të zotëruara nga Shitësi në Shoqërinë "ITE. Grup"shpk në masën 100% (njëqind përqind).

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "ITE. Grup"shpk të datës 03.01.2022 është vendosur për transferimin përmes blerjes së kuotave të kapitalit në masën 100% (njëqind përqind) në shoqërinë "ITE. Grup"shpk.

ATËHERË

Palët lidhin marrëveshjen me kushtet e mëposhtme:

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

1.1 Shitësi shet, dhe Blerësi blen 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë "EUROTEST" shpk në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, NUIS L11823002I, me seli në Kashar Mëzez, objekti me nr.pasurie 7/43, zona kadastrale 2679, Tiranë me kapital të regjistruar prej 100.000 Lekë.

NENI 2

VLERA E KONTRATËS

2.1 Cmimi i shitjes është pranuar dhe dakortësuar nga palët në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Leke (tani e më poshtë referuar si "Çmimi"). Palet deklarojnë se pagesa e cmimit është kryer plotësisht nga Blerësi të Shitesit.

NENI 3

EFEKTET E KONTRATËS

3.1 Duke filluar nga data e kësaj marrëveshje Blerësi do të zotërojë 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë "EUROTEST" shpk, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, ndërsa Shitesit humbet të gjitha të drejtat mbi kapitalin e shoqërisë që i ka shitur blerësit.

NENI 4

TË NDRYSHME

4.1. Shitesit deklaron se nuk ka asnjë kufizim mbi të drejtat mbi kapitalin e shoqërisë "EUROTEST" shpk dhe se ato janë të lira kundrejt çdo lloj kufizimi, barre apo detyrimi.

4.2. Në rast mosmarrëveshje të palëve mbi kushtet, detyrimet dhe interpretimin e kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për ti zgjidhur me mirëkuptim. Në rast të kundërt Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve.

4.3. Kjo marrëveshje është përgatitur në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe që kanë të njëjtën vlerë juridike.

4.4. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët.

PALËT

Shitësi

Isuf KORE

Isuf Kore
[Signature]

Blerësi

Shoqëria "ITE. GRUP" shpk

Sokol ZOTKAJ

Sokol Zotkaj
[Signature]

